

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Koncepti elektrik i Volkswagen synon mbi 1,400 kilometra autonomi me një karikim
ADRESA	https://albeu.com/teknologji/auto/koncepti-elektrik-i-volkswagen-synon-mbi-1400-kilometra-autonomi-me-nje-karikim/1011594/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:27:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:20:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8278717f9d63c06dcb3ca197d4fc9ec7de4e5dc041c39904905cb5aec073a093
TEKSTI	27cfe15731e00dbacdd6b61bd8a9f4ccc81b247f1a9ff3636d4e086f5caf75c7
PAMJA	b536700b35937b353c5e63e48e78436f76252215c6f9738da12ec118013d039e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ecf784eca2e8ca2b629903b9835ab375bd45aec4121277ad9ec39ed6eee94ad8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ecf784eca2e8ca2b629903b9835ab375bd45aec4121277ad9ec39ed6ee94ad8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Koncepti elektrik i Volkswagen synon mbi 1,400 kilometra autonomi me një karikim



Volkswagen ka zbuluar Mission Efficiency, një koncept elektrik i krijuar për të çuar efikasitetin në një nivel të ri dhe që, sipas përlogaritjeve teorike, mund të kalojë 1,400 kilometra autonomi me një karikim të vetëm.

Forma e automjetit sugjeron se është zhvilluar me fokus maksimal të tuneli aerodinamik. Pikërisht ulja e rezistencës së ajrit përbën një nga elementet kyçe që shpjegon rezultatet e arritura, transmeton Telegrafi.

Ky projekt rikthen idenë e "one-liter car" nga periudha e Ferdinand Piëch, një filozofi që pati kulmin e saj me modelin shumë aerodinamik XL1.

Në vend që të mbështetet në zgjidhje teknologjike të pazakonta, Mission Efficiency përdor gjerësisht komponentë ekzistues të Volkswagen. Ajo ndërtohet mbi platformën MEB+, ka lëvizje me rrotat e përparme dhe ndan motorin elektrik dhe baterinë me ID. Polo.

Rekord në aerodinamikë

Volkswagen thotë se Mission Efficiency arrin një koeficient të rezistencës së ajrit prej vetëm 0.158, shifër që kompania e paraqet si më të ulëtën për një automjet rrugor të prodhuar ndonjëherë.

Ndikim të rëndësishëm në këtë rezultat ka edhe sipërfaqja e vogël ballore, e cila është vetëm 2.08 metra katrorë dhe kontribuon në uljen e mëtejshme të rezistencës aerodinamike.

Kompania realizoi edhe një provë "ideale", ku automjeti lëviz vazhdimisht me 68 km/h në një segment tërësisht të sheshtë, me klimën dhe pajisjet e tjera ndihmëse të çaktivizuara. Në këto rrethana, konsumi ishte vetëm 6.48 kWh për 100 kilometra.

Përshkoi 1,278 kilometra

të fundit /



QMK: Nga 14 zjarret e raportuara, vetëm ai pranë Borinos vijon t...



Amedspor befasues në elitën turke, Hasi dhe dy reprezentuesit e...



Nagavci: Tërheqja e Sejdiut është humbje për procesin e...



Bekim Sejdiu tërhiqet nga gara për President të Kosovës: Partitë të...



Pas protestave në Serbi, Vuçiq njofton dorëheqjen: Do të...



Cela kërkon protestë për viktimat e pasluftës në Kosovë: Drejtësia...



Mes birëve të demit 540 kilogramësh për mbi 10 sekonda, Roc...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Testi kryesor u zhvillua në kushte reale, në një itinerar nga qendra e zhvillimit e Volkswagen në Wolfsburg deri në Vjenë, duke kaluar përmes Poznanit në Poloni dhe Olomoucit në Çeki.

Distanca e regjistruar zyrtarisht arriti në 1,278.36 kilometra. Shpejtësia mesatare në këtë udhëtim ishte 67.72 km/h, ndërsa maksimumi i shënuar ishte 138 km/h.

Mission Efficiency shpenzoi 7.51 kWh/100 km gjatë rrugës, përfshirë humbjet e krijuara në procesin e karikimit. Nëse këto humbje përjashtohen, konsumi zbrit në 6.89 kWh/100 km.

Bateria me kapacitet neto 54.9 kWh u karikua vetëm një herë gjatë gjithë itinerarit. Pas mbërritjes në Vjenë, Volkswagen njoftoi se automjeti ruante ende 164 kilometra autonomi.

Kjo nënkupton se autonomia totale teorike, në kushtet e kësaj prove, tejkalon 1,400 kilometra.

Rekordi i tretë: efikasiteti

Record Institute for Germany (RID) e ka certifikuar Mission Efficiency si automjet elektrik "pranë prodhimit, për përdorim të përditsëm, me katër vende", duke i njohur një rekord tjetër në efikasitet.

Volkswagen ka synuar që ky koncept të mos kufizohet vetëm si një demonstrim teknik. Automjeti është konceptuar si coupé 2+2, me një derë të madhe të pasme dhe afërsisht 481 litra hapësirë për bagazhe.

Ulëset e pasme mund të përdoren nga pasagjerë me gjatësi deri në rreth 1.60 metra. Sipas kompanisë, në teori makina mund të shërbejë edhe për një familje të re me katër anëtarë.

Palosja e sediljeve të pasme krijon një zonë ngarkese deri në 1.8 metra të gjatë. Hapësira magazinimi janë parashikuar edhe nën sediljet e pasme, si edhe pas mbulesave të rrotave të pasme.

Dizajn i frymëzuar nga XL1

Nevoja për të reduktuar rezistencën e ajrit ka udhëhequr në masë të madhe paraqitjen e Mission Efficiency. KarrocERIA ka një profil të ulët dhe të zgjatur, me frymëzim të dukshëm nga XL1.

Dimensionet e automjetit janë 4,775 mm gjatësi, 1,744 mm gjerësi dhe vetëm 1,392 mm lartësi, ndërsa distanca ndërmjet boshteve është 2,700 mm.

Pjesa e pasme ngushtohet gradualisht duke marrë formën e një pike uji. Rrotat e pasme mbulohen pjesërisht, ndërsa çatia e zgjatur përdor zgjidhjen që Volkswagen e quan "boat tailing".

Me këtë formë synohet që ajri të ndjekë karrocERINë për sa më gjatë, përpara se të shpëputet në mënyrë të pastër në fund të automjetit.

Në pjesën e përparme janë vendosur tre kapakë aktivë për ftohje, të cilët hapen veçmas ose njëkohësisht në pesë konfigurime të ndryshme. Mbyllja e të treve i mundëson makinës të arrijë koeficientin 0.158.

Edhe rrotat janë optimizuar

Volkswagen ka trajtuar me vëmendje të posaçme rrotat, pasi ato mund të jenë përgjegjëse për rreth 25 deri në 30 për qind të rezistencës aerodinamike të një automjeti.

Për këtë qëllim, Mission Efficiency përdor deflektorë të posaçëm, të cilët kufizojnë hyrjen e ajrit në hapësirat e rrotave dhe pakësojnë turbulencat.

Gomat e veçanta Continental, të zhvilluara mbi bazën e EcoContact 7, bashkojnë rezistencën e ulët në rrotullim me anësore të përshtatura për aerodinamikë.

Volkswagen ka zgjedhur pasqyrat klasike në vend të kamerave. Sipas testeve të kompanisë, përfitimi në efikasitet nga kamerat nuk rezultoi mjaftueshëm i madh për të arsyetuar koston dhe shpenzimin shtesë të energjisë.

Pothuajse e gjithë pjesa e poshtme e makinës është e mbuluar. Për të përmirësuar rrjedhën e ajrit nën automjet, boshti i pasmë është bërë 170 mm më i ngushtë krahasuar me ID. Polo.

Motor i zakonshëm, rezultat i jashtëzakonshëm

Nën karrocERINë me pamje futuriste gjendet teknologji relativisht e njohur.

Mission Efficiency pajiset me motorin sinkron me magnet të përhershëm APP290, të njëjtin motor që përdoret nga ID. Polo. Ai zhvillon 135 kuaj fuqi dhe 264 Nm çift rrotullues, peshon vetëm 75 kilogramë dhe lidhet me një transmision me një shpejtësi.

Furnizimi me energji sigurohet nga një bateri NMC me kapacitet 54.9 kWh.

Për automjetin që iu nënshtua testit, Volkswagen e rriti përkohësisht me 2.9 kWh kapacitetin e përdorshëm të baterisë përmes softuerit. Kompania sqaron se versionet e prodhimit lënë me qëllim një pjesë të energjisë të papërdorur, për të maksimizuar jetëgjatësinë e baterisë.

Karikimi DC mund të shkojë deri në 105 kW, ndërsa sistemi AC mbështet karikim deri në 11 kW.

Panelet diellore shtojnë edhe 30 kilometra në ditë

Efikasiteti i konceptit nuk mbështetet vetëm te bateria dhe aerodinamika. Volkswagen ka vendosur panele fotovoltaike në çatinë prej xhami dhe në derën e pasme.

Sistemi 370 vatësh nuk furnizon drejtpërdrejt baterinë, por mbulon nevojat e sistemeve elektrike të automjetit. Në kushte ideale dhe në varësi të stinës. vendndodhies dhe motit. ai mund të shtoi deri në 30 kilometra autonomi

në ditë.

Edhe kabina është ndërtuar për të kursyer peshë

Qasja e kursimit të energjisë është zbatuar edhe në ambientin e brendshëm.

Në vend të një ekrani të zakonshëm infotainment, Volkswagen ka zgjedhur një zgjidhje më të thjeshtë, të ngjashme me atë të modelit të vogël up!. Shoferi mund të vendosë një smartphone ose tablet Android apo Apple në një mbajtëse të integruar dhe ta lidhë atë pa tel me automjetin.

Altoparlantët e integruar të përhershëm nuk janë përdorur. Në vend të tyre shërben një altoparlant portativ Bluetooth, çka redukton peshën dhe numrin e komponentëve elektrikë.

Edhe panelet e dymve dhe ulëset janë të lehta, ndërsa disa prej pjesëve janë krijuar për riciklim të plotë.

Dysheimeja përdor po ashtu një material kompozit të lehtë me kapje gome të integruara, duke shmangur nevojën për tapete të veçantë.

Kështu, Volkswagen ka ndjekur një koncept të drejtpërdrejtë: më pak peshë, më pak rezistencë ndaj ajrit dhe më pak humbje energjie, në vend të një motori ose baterie gjigante.

Rezultati është një automjet elektrik që, të paktën në kushtet e testimit, regjistron autonomi të krahasueshme me një udhëtim prej më shumë se 1,400 kilometrash. /Telegrafi/

Shtuar më 14.09.2026 21:20

Tags: [veturat elektrike](#) , [Volkswagen](#)



Tesla cakton prezantimin e Roadster-it pas nëntë vitesh pritje



Volkswagen prezanton teknologjinë për ndërrim automatik të korsisë



BMW tërheq 189,130 automjete për shkak të rrezikut të zjarrit në motor



Këto janë automjetet me mundësinë më të madhe për të kaluar 400 mijë...



Genesis Magma GT shfaqet në aksion me zërin e një V8 twin-turbo dhe d...



Koleksioni i familjes Born nxjerr në ankand 300 makina klasike, ofertat ni...



Ram prezanton ProMaster City 2027: furgon modern me çmim fillestar 39,995...



Rimac zgjeron kontrollin mbi Bugatti-n pas marrëveshjes së re të...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.